

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 29, datë 09/10/2019

PËR

**“MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE, CIKLI I PARË DHE CIKLI I DYTË TË  
STUDIMEVE, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA, PËR VITIN  
AKADEMIK 2019-2020”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 3, pikën 1 shkronjat a, dh dhe f të nenit 38 si dhe të pikave 1, 4 dhe 6 të nenit 39 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; shkresën e Dekanit të Fakultetit të Arteve të Bukura mbi dërgimin e planeve mësimore për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2019-2020; si dhe në prezantimin e të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2019-2020, nga Drejtuesit e Departamenteve dhe pasi e diskutoi,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e planeve mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2019-2020, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Arteve të Bukura.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

St. Fas. Urim ALIAJ

St.Fm. Rajmond PRENDUSHI